

	Kontrolli periodik i sistemit të zjarrit ne impiantet e Gazsjellesit TAP	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	12.2023
		Faqe 1 of 21	

Kontrolli periodik i sistemit të zjarrit ne impiantet e Gazsjellesit TAP

Specifikime Teknike/Terma Reference

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Page 2 of 21		

INDEKSI

1	QËLLIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE	4
2	KONTEKSTI I REFERIMIT	4
2.1	SHKURTIME DHE PËRCAKTIME	5
3	FUSHA E APLIKIMIT	5
4.	VENDODHJA E IMPIANTEVE TE TAP NE SHQIPERI	6
5.	PËRSHKRIMI I AMBJENTEVE TAP DHE AGSCO NË SHQIPËRI	6
5.1	STACIONI I MATJEVE NË BILISHT (ACS02).....	6
5.2	ABV STACIONI SHQIPTAR I VALVULAVE TË BLOKIMIT	7
5.3	STACIONI KOMPRESOR I FIERIT (ACS03).....	8
6.	AKTIVIMI I SHËRBIT, HYRJA NË OBJEKTET E TAP	9
7.	PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE QË NEVOJITEN	11
7.1	RITESTIMI, RIMBUSHJA E BOMBOLAVE.....	11
7.2	RIMBUSHJA E BOMBOLAVE DHE RICERTIFIKIMI I BOMBULAVE	12
8.	MINIMUMI I TESTIMEVE TE NEVOJSHME.....	12
8.1	SISTEMI I ALARMIT TE ZJARRIT	12
8.2	SISTEMI I FIKJES ME GAZ INERT (GODINA ELEKTIRKE).....	13
8.3	SISTEMI I FIKJES SE TURBINA VE ME CO2	13
8.4	TESTI FUNKSIONAL I HIDRANTEVE DHE RRJETIT TE HIDRANTEVE.....	14
8.5	INSPEKTIMI I TUBAVE TE HIDRANTEVE	14
8.6	KONTROLI I RREZERVUARIT TE UJIT	14
8.7	KONTROLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES JOCKEY	15
8.8	KONTROLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES ELEKTRIKE.....	15
8.9	KONTROLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES DIESEL.....	15

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
		Faqe 3 of 21	

8.10	KONTROLLI I SISTEMIT TE SPRINKLERAVE DHE KONTROLLI I SISTEMIT TE SHKUMËS (TESTOHEN SEBASHKU)	15
8.11	KONTROLLI I DALJEVE EMERGJENCES DHE KONTROLLI I SINJALISTIKES SE EMERGJENCES.....	17
9.	RAPORTI I KONTROLLIT – CERTIFIKATA PERIODIKE VJETORE.....	17
10.	SHSM (SHËNDETI, SIGURIA & MJEDISI).....	17
11.	DETYRIMI I KONTRATËS	19
12.	Garancite	21

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 4 of 21		

1 QËLLIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Ky dokument përcakton qëllimin e punës dhe veprimtaritë teknike të kontrollit që do t'i kërkohen Operatori Ekonomik në kuadër të kontratës së impanteve kundërzjarrit të palëvizshme dhe të lëvizshme të instaluar pranë Ambjenteve TAP e AGSCo në Shqipëri. I njëjti dokument rregullon gjithashtu edhe marrëdhëniet e punës midis shoqërisë AGSCo e dhe Operatori Ekonomik që do t'i caktohet kontrata.

Operatori Ekonomik që do të marrë përsipër kontratën do të jetë përgjegjës për të garantuar që dokumenti në fjalë i Specifikimeve Teknike të aplikohet tërësisht jo vetëm nga punonjësit e tij, por edhe nga nënkontraktorë të mundshëm të cilëve mund t'u caktojë zbatimin e disa fazave të shërbimit. Kohëzgjatja e kontratës do jete deri me 30.09.2025.


2 KONTEKSTI I REFERIMIT

Në vazhden e marrëveshjeve të firmosura midis TAP dhe autoriteteve shqiptare, Snam Spa (Italian Transmission System Operator) e Albgaz (Albanian Transmission System Operator), kanë krijuar një joint venture të quajtur AGSCo (Albanian Gas Service Company Sh.A.), për zbatimin e veprimtarive të Kontrollit së gazsjellësit TAP (Trans Adriatic Pipeline) prezent në territorin e Shqipërisë. Pjesa shqiptare e gazsjellësit TAP është rreth 215 km dhe shtrihet nga kufiri greko-shqiptar në afërsi të Bilishtit dhe deri në kufirin me detin Adriatik në qarkun e Fierit. Gazsjellësi përshkon qarqet Korçë, Berat dhe Fier. Sistemi i transportit të gazit është i përbërë nga një tubacion i nëndheshëm që ka një diametër kryesor prej 48" (1.200 mm), 9 valvola sigurie të linjës (ABVs), një stacion matje fiskale të vendosur në Bilisht (ACS02) në kufirin shqiptaro grek dhe nje stacion të kompresimit të gazit (ACS03) në rrethinat e Fierit i pajisur me tre turbokompresorë të fuqisë së instaluar prej 45 MW. Presioni maksimal i funksionimit të gazsjellësit është 90 bar ndërsa stacioni i kompresorit është funksional deri në presionin maksimal prej 145 bar.

Prezenca e ambjenteve TAP në territorin e shqipërisë është e treguar në hartën e më poshtme:



Fig. 1 – Vendodhja e ambjente TAP përmes shtetit shqiptar.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 5 of 21		

2.1 SHKURTIME DHE PËRCAKTIME

ACS02	Stacion Shqiptar i Matjes 02. Vendndodhja në Bilisht.
ACS03	Stacioni Shqiptar I Kompresorit 03. Vendndodhja në Fier.
ABV	Stacioni Shqiptar i Valvulave të Bllokimit (ABV24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31)
ALV	Stacioni Shqiptar I Bashkimit të Valvulave (ALV32).
HSE	Health, Safety and Environment. Shëndeti, Siguria dhe Ambjenti.
AGI	Above Ground Installation. Instalime mbi Tokë
TAP	Trans Adriatic Pipeline.
AGSCo	Albania Gas Service Company.
TAP Facilities	ACS02, ACS03, ABV.
MC	Maintenance Centre. Qendra e Kontrollit
AGSCo	Korce MC, Fier Detachment, Corovodë Detachment, Tirana HQ
PPE	Personal Protection Equipment. Pajisje Mbrojtëse Personale
PTW	Permit To Work. Leje për Punë
WI	Work instructions TAP. Instruksionet e Punës së TAP
AGS-TSP-001	Maintenance of Fire and Gas Systems: Technical Specification Kontrolli i Sistemeve të Gazit dhe Zjarrit: Specifikimet Teknike
Kontrata	Kontratë mirëmbajtje kundërzjarrit shërbimet e të cilës janë përcaktuar në Specifikimet Teknike të AGS-TSP-001.
Operatori	Kontraktor të cilit do t'i besohet zbatimi i kontratës.
ATEX	ATmosphères Explosives; Ambjent eksploziv

3 FUSHA E APLIKIMIT

Impiantet kundërzjarrit objekt i këtij dokumenti Specifikimesh Teknike janë të vendosura për mbrojtjen e ndërtimeve dhe aparateve të impiantit (Ambjenteve) të instaluar pranë Stacionit të Kompresorit në Fier (ACS03), Stacioni i Matjes së gazit në Bilisht (ACS02), Stacionet e 9 Valvulave të Bllokimit (ABV). Këto impiante kundërzjarrit, vendosjet e të cilave janë të caktuara në Seksionin 12, janë të përfaqësuara si më poshtë:

- Impiante dhe postacione kundërzjarrit për mbrojtjen e ambjenteve të ngritura në Stacionin Matës të Bilishtit (ACS02);
- Impiante dhe postacione kundërzjarrit për mbrojtjen e ambjenteve të ngritura në Stacionet e 9 Valvulave të Bllokimit (ABVs);
- Impiante dhe postacione kundërzjarrit për mbrojtjen e ambjenteve të ngritura në Stacionin e Kompresorit të Fierit (ACS03);

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 6 of 21		

Përshkrimi dhe karakteristikat e impianteve për mirëmbajtje janë të specifikuar në Seksionin 4 të këtij dokumenti.

4. VENDODHJA E IMPIANTEVE TE TAP NE SHQIPERI

TAP Facilities	GPS Position
ACS02 – Bilisht Metering Station	Latitude: 40.582582°
Bilisht - Korce	Longitude: 21.000683°
ABV 24	Latitude: 40.690506°
Proger	Longitude: 20.924912°
ABV 25	Latitude: 40.589963°
Drenove	Longitude: 20.720251°
ABV 26	Latitude: 40.517906°
Vithkuq	Longitude: 20.531710°
ABV 27	Latitude: 40.491486°
Potom	Longitude: 20.294908°
ABV 28	Latitude: 40.540174°
Vendreshe	Longitude: 20.108435°
ABV 29	Latitude: 40.675747°
Vertop	Longitude: 20.022549°
ABV 30	Latitude: 40.770815°
Ura Vajgurore	Longitude: 19.855615°
ABV 31	Latitude: 40.768788°
Roskovec	Longitude: 19.694532°
ALV 32	Latitude: 40.793353°
Topoje	Longitude: 19.385136°
ACS03 – Fier Compressor Station	Latitude: 40.791871°
Seman - Fier	Longitude: 19.453191°

5. PËRSHKRIMI I AMBJENTEVE TAP DHE AGSCO NË SHQIPËRI

5.1 STACIONI I MATJEVE NË BILISHT (ACS02)

Për qëllimin e objektivave të punës, Stacioni i Matjes në Bilishtit (ACS02) konsiston në impiantet si më poshtë:

- Ene për kapjen dhe lëshimin e PIG-eve prej 48" dhe sisteme ndihmëse;
- Sistem filtrimi të gazit dhe sistem mbledhësh substancash të filtruara të ngurta dhe të lëngshme;
- Sistem valvulash bllokimi dhe by-pass Stacioni;
- Sistem matje sasiore dhe cilesore të gazit (gaz kromatografi);
- Vent-stack (tub ventilimi) i stacionit;
- Sistem ushqyerje elektrike MT/bt, gjenerator Naftë si rezervë energjie, sistem tokëzimi dhe mbrojtje elektrike;

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 7 of 21		

- Sallë kuadër energjie dhe komandimi, UPS me sistem mbledhje me bateri, Sallë Kontrolli dhe sistem mbledhje me bateri, Sallë Kontrolli dhe sistem DCS;
- Sistem kundërzjarrit të realizuar me aparatura dhe mekanizma fikse dhe lëvizëse për mbrojtjen e ambjenteve mbi tokë;
- Ndërtim për vendosje e aparaturave elektrike të fuqisë dhe komandimit, të vendosjes së pompave elektrike dhe me naftë, të zyrave dhe ambjenteve tualete.

Impiante kundërzjarrit të instaluar në brendësi të Ndërtesës konsistojnë në fikës zjarri me gaz inert, fikës me pluhur, sinjalizues tymi statikë, dyer kundra zjarrit, dalje emergjence me doreza antipanik, sistem shuarje me bombula me CO2 për impiantet elektrike të instaluar në salat e paneleve.

Për mbrojtjen e ambjenteve mbi terren të instaluar në Stacionin e atjeve është parashikuar:

- Sistem kundër zjarrit me ujë i përbërë nga rrjet fiks në formë unaze, me uje dhe hidrante;
- Depozite mbledhëse e ujit kunderzjarrit, pompa kundërzjarrit elektrike dhe pompa kundërzjarrit Sistemi kompletohet me aparatë dhe panele elektrikë-elektronikë komandimi që marrin informacione mbi gjendjen e sistemit nëpërmjet sensorëve gazi të instaluar në fushë në afërsi të impianteve të gazit;
- Sistem fikje i palëvizshëm me bombula gazi inert e sistem përkatës elektronik kontrolli dhe ndërhyrje;
- Fikës zjarri të lëvizshëm dhe me rrota, me CO2 dhe me pluhur;
- Dyer kundërzjarrit prerëse të zjarrit të instaluar në Ndërtesa dhe daljet e emergjencës të instaluar në rrethimin e jashtëm.

Vendodhja e ACS02 është e përcaktuar nga koordinatat GPS të përcaktuara në Seksionin 4 të këtij Dokumenti të Specifikave Teknike.

5.2 ABV STACIONI SHQIPTAR I VALVULAVE TË BLOKIMIT

stacionet ABV bëjnë pjesë në ambjentet e TAP-it në Shqipëri dhe janë në total 9 (nëntë), të shpërndara në kompetencë të Qëndrave të Mirëmbajtjejs (QM) sic është përshkruar më poshtë:

- ABV-24, ABV-25, ABV-26 të instaluar në qarkun e Korcës dhe në kompetencë të QM Korcë;
- ABV-27, ABV-28, ABV-29, ABV-30, ABV-31, ALV-32 të instaluar në qarqet Corovodë, Berat e Fier e janë në kompetencë të QM-së të Beratit;

pozicioni i cdo ABV-je është i përcaktuar nga koordinatat GPS të përcaktuara në Seksionin 4 të këtij Specifikimi Teknik.

Përbërja e mekanizmave kundër zjarrit të ABV-ve konsiston në fikës zjarri të lëvizshëm me CO2 dhe me pluhur, për përdorim të jashtëm e të brendshëm.

Për një përshkrim më të kujdesshëm të veprimtarive të Kontrollit që duhet të kryhen pranë ABV-ve të shikohet Seksioni 3 i SHTOJCËS 1.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Page 8 of 21		

5.3 STACIONI KOMPRESOR I FIERIT (ACS03)

Për të realizuar objektivin e punës Stacioni Kompresor i Fierit (ACS03) është i përbërë nga impiantet e mëposhtme:

- Ene për kapjen e PIG-eve prej 48" dhe lëshimin e PIG-ve prej 36" dhe sisteme ndihmëse;
- Sistem filtrimi të gazit dhe sistem mbledhesh substancash të filtruara të ngurta dhe të lëngshme;
- Sistem valvulash interceptimi dhe by-pass i Stacionit;
- Gaz coolers (freskues) e shërbimet e tij ndihmëse
- Sistem matje sasiore dhe cilesore të gazit (gaz kromatografi);
- Vent-stack (tub ajrimi) i stacionit dhe sistemet e tij kundërzjarrit;
- 3 (tre) Njësi kompresioni gazi të pajisura me turbina me gaz dhe kompresorë centrifugë të procesit;
- Sistem ushqyerje elektrike MT/bt, impiante elektrike shpërndarje, gjeneratorë elektrikë të ushqyer me gaz, gjeneratorë elektrikë me Naftë si rezervë energjie, sistem tokëzimi dhe sistem mbrojtje katodike;
- Sallë kuadër energjie dhe komandimi, UPS stacioni me sistem akumulimi me bateri, Sallë Kontrolli dhe DCS për kontrollin e stacionit dhe njësitë e kompresionit;
- Kompresorë zonë shërbimesh dhe sistem shpërndarje e ajrit të kompresuar;
- Sistem kundërzjarrit të realizuar me aparatura dhe mekanizma fikse dhe lëvizëse, të instaluar edhe në kushtet ATEX;
- Ndërtim për vendosjen e aparaturave elektrike të fuqisë dhe komandimit, të vendosjes së pompave elektrike dhe me naftë, të Zyrave administrative, oficinave dhe ambjenteve tualete.

Impiantet kundërzjarrit në brendësi të Ndërtesave administrative, Ndërtesave të Magazinave, Ndërtesës së sallës kontrollit dhe sallës kuadër, përbëhen nga fikës zjarri me CO₂, fikës me pluhur, zbulues tymi, dyer prerësezjarri REI, dalje emergjence dhe doreza antipanik, sistem shuarje me bombul me CO₂ për impiantet elektrike në sallat e kuadrit.

Në mbrojtje të ambjenteve mbi terren të instaluar në Stacionit e Kompresorit është parashikuar:

- Sistem kundër zjarrit me ujë i përbërë nga rrjet fiks në formë unaze, ujitës, tuba me grykë antizjarr;
- Serbator mbledhës i ujit kundërzjarrit, pompa kundërzjarrit elektrike dhe pompa kundërzjarrit booster (me Naftë). Sistemi kompletohet me aparatë dhe kuadër elektrikë/elektronikë komandimi që marrin informacione mbi gjendjen e sistemit nëpërmjet sensorëve gazi të instaluar në fushë në afërsi të impianteve të gazit në zbatim të ATEX;
- Sistem fikës i palëvizshëm me bombula CO₂/N₂ e sistem përkatës elektronik kontrolli dhe ndërhyrje;
- Sistem zbulues gazi të instaluar në afërsi të impianteve me prezencë gazi dhe në kabinat e njësisë së kompresionit;
- Sistem shuarje i quajtur Water-Mist që vihet në veprim nga bombula me N₂ dhe shkumues Fikës;
- Fikës zjarri të lëvizshëm dhe me rrota me CO₂ dhe me pluhur;
- Dyer kundërzjarrit prerëse të zjarrit të instaluar në Ndërtesa dhe dalje të emergjencës të instaluar në rrethimin e jashtëm.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 9 of 21		

Për një përshkrim me të detajuar të veprimtarive të Kontrollit që do të kryhet në ACS03 të shikohet Seksioni 7

Vendndodhja e ACS03 është e përcaktuar nga koordinatat GPS pjese e ketij dokumenti.

6. AKTIVIMI I SHËRBIMIT, HYRJA NË OBJEKTET E TAP.

Të gjitha kontrollet janë pjesë e planit të mirëmbajtjes që AGSco duhet të ekzekutojë. Shërbimi i kontrollit duhet të kërkohet nga AGSCo e cila do të aktivizojë operatorin ekonomik neperjmet email ose telefonit. Hyrja e kontraktorit në impiantet e TAP-it do të lejohet vetëm në prani të një përfaqësuesi të AGSCo, i cili do të ofrojë asistencë teknike dhe administrative.

Inspektimi normalisht do të kërkohet me e-mail nga AGSCo. Në kërkesë AGSCo do të specifikojë:



- Vendndodhja e objektit
- Detajet e pajisjeve
- Lloji i inspektimit

Operatori Ekonomik do të ketë personel kompetent i cili eshte eshte i afte te realizoje qellimin e punes. Operatori Ekonomik duhet të kryejë ndërhyrjen brenda një afati maksimal prej 5 ditësh, duke filluar nga data e kërkesës dhe në çdo kohë të vitit. Nëse kërkesa dorëzohet të premten, e shtuna do të përfshihet në numërim.

Për të kryer shërbimin, kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë e personelit dhe pajisjeve të nevojshme. Të gjitha pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të jenë të certifikuara dhe të kenë një certifikatë të vlefshme kalibrimi.

I gjithë procesi, nga momenti i kërkeses se Autoritetit Kontraktor deri ne procesin perfundimtar te faturimit do te realizohet sipas diagrames se meposhteme:

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
		Faqe 10 of 21	



Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 11 of 21		

7. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE QË NEVOJITEN

Per te gjithë sistemet e meposhteme te cilat ndodhen ne ACS03 Seman dhe ACS02 Bilisht Operatori Ekonomik duhet te kryhej nje **kontroll/testim dhe certifikim** periodik cdo vit dhe te garantohet qe:

- Sistemi eshte funksional ne perputhje me parametrat e projektimit
- Prove funksionale e ketyre sistemeve dhe venja ne dukje e anomalive te mundshme
- Nuk jane kryer modifikime apo riparime te paautorizuara
- Sistemet jane ne perputhje me projektin e mbrojtjes nga zjarri

Ne perfundim te ketyre kontrolleve per cdo sistem te listuar meposhte, Operatori ekonomik do te leshoje nje raport inspektimi dhe certifikate te vulosur edhe firmosur nga eksperti zjarrfikes.

Sistemet te cilat do te kontrollohen dhe certifikohen ne menyre periodike jane:

1. SISTEMI I ALARMIT TE ZJARRIT
2. FIKSET TË ZJARRIT PORTABËL
3. SISTEMI I FIKJES ME GAZ INERT (Godina elektirke)
4. SISTEMI I FIKJES SE TURBINAVE ME CO2 (sistemi mbrojtjes i turbinave)
5. TESTI FUNKSIONAL HIDRANTEVE DHE RRJETIT TE HIDRANTEVE
6. INSPEKTIMI I TUBAVE TE HIDRANTEVE
7. KONTROLLI I RREZERVUARIT TE UJIT TE SISTEMIN E ZJARRIT
8. KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES JOCKEY
9. KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES ELEKTRIKE
10. KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES DIESEL
11. KONTROLLI I SISTEMIT TE SPRINKLERAVE
12. KONTROLLI I SISTEMIT TE SHKUMËS (perfshire edhe analizen e shkumes)
13. KONTROLLI I DALJEVE EMERGJENCES dhe KONTROLLI I SINJALISTIKES SE EMERGJENCES

Cdo detaj i projektimit, vizatime apo skica teknike te cilat i nevojiten Operatorit Ekonomik per realizimin e qellimit te kontrates do ti vihen ne dispozicion Operatorit Ekonomik nga Autoriteti Kontraktor. Informacioni paraprak per keto sisteme gjendet ne ANEKSI 1 Te dhena teknike te paisjeve dhe sistemeve te mbrojtjes nga zjarri

7.1 RITESTIMI, RIMBUSHJA E BOMBOLAVE

Operacionet e lëvizjes të bombolave (çmontimi nga sistemi, ngarkimi në mjetet e transportit të Operatori Ekonomik, shkarkimi i mëtejshëm dhe rimontimi në impjant do t'i ngarkohen plotësisht Operatori Ekonomik.

Ky proces duhet të kryhet duke përdorur një autolaborator të certifikuar të lëvizshëm që do të parkohet jashtë çdo impianti ne ne momentin qe do te kryhet rimbushja/ricertifikimi i bombulave.

Kjo do të lejojë një proces më të shpejtë ricertifikimi/rimbushjeje dhe duke shmangur mungesen fikseve ne impiant.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
		Faqe 12 of 21	

I gjithë procesi do të monitorohet nga ekspertet e Agsco dhe TAP të cilët ndodhen pranë impaiteve në cdo ditë të vitit, në mënyrë që të garantohet një rimbushje dhe kontroll në përputhje me standardet e sigurisë të mbrojtjes nga zjarri.

7.2 RIMBUSHJA E BOMBOLAVE DHE RICERTIFIKIMI I BOMBULAVE


- Në rast të rimbushjes së bombulave të zbrazëta, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë:
- Numri unik i bombules korespondon me atë të ndodhur në projektin e mbrojtjes nga zjarri të impiantit dhe vendodhja e tij është ajo e percaktuar në planimetrinë e impiantit.
- të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për rishikimin e valvulës së montuar në bombulë, etiketimin dhe materialet e nevojshme të konsumit;
- në rastin e bombulave me të cilat ndodhen në karrel të kontrollohet gjendja e karrelit, rrotat, mbajtësit kapset dhe të gjithë elementet perberes.
- rimbushja e bombulës me mjetin e duhur të shuarjes në përputhje me standrdert nderkombetare.
- Verifikimi i instrumentit që tregon nivelin e mbushjes
- Në rastin e bombulave me CO2 verifikimi i nivelit të mbushjes do të bëhet me anë të peshimit të bombules. Duhet të jetë brenda 110% e peshës së tij origjinale e cila do të vendoset në trupin e fikësit. Peshimi duhet të bëhet me peshore të kalibruar.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet që do të përdoren në rimbushjen e bombulave. Kjo vlen për cdo produkt që do të përdoret për rimbushje, përfshirë CO2
- Në përfundim të procesit të rimbushjes dhe ricertifikimit, operatori ekonomik duhet të vendosi një stiker mbi bombulë ku të tregojë minimalisht: Datën e ricertifikimit, Tag numrin e bombules, datën e inspektimit të ardhshëm

8. MINIMUMI I TESTIMEVE TË NEVOJSHME

Për sistemet e mëposhteme, gjatë kontrollit periodik dhe përpara se të Certifikohet sistemi, Operatori Ekonomik do të kryejë minimumin e testimeve të kërkuara nga Prodhuesi dhe nga klienti TAP. Këto testime do të jenë si më poshtë.

8.1 SISTEMI I ALARMIT TË ZJARRIT

- Inspektimi vizual i komponentëve të sistemit për shenja dëmtimi fizik, hyrje uji, mbinxehje dhe korrozioni.
- Kontrolli i percjellave, gërvishtjet dhe mbulesat e spaisjeve për dëmtime, dhe gjendjen e përgjithshme.
- Kontrolli i pastërtisë së përgjithshme të instalimit
- Konfirmimi i instrumentave të sistemit.
- Simulimi i alarmit të zjarrit dhe venja në punë e sinjalistikës perkatese.
- Verifikimi i alarmit të gazit tek detektorët e gazit të tipit Crowcon IR Max nëpërmjet bombules me gaz të kalibruar dhe verifikimi i funksionalitetit të alarmit sipas parametrave të projektimit.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 13 of 21		


- Verifikimi i alarmit te zjarrit tek sensoret e zjarrit me rreze infra te kuqe te tipit Honeywell Analytics, modeli FS24X dhe verifikimi i funksionalitetit te alarmit sipas parametrave te projektimit
- Verifikimi i alarmit te tymit dhe nxehtesise tek - Sensoret te kombinuar per dedektimin e tymit dhe nxehtesise APOLLO, ORB-OH-53028-APO
- Verifikimi i alarmit nepermjet Pika te thirrjes (MAC) dhe kontrolli i funksionalitetit te tyre.
- Vini re statusin e alarmit në panelin e zjarrit dhe gazit dhe në DCS të shoqëruar me personelin e Autoritetit Kontraktor.

8.2 SISTEMI I FIKJES ME GAZ INERT (GODINA ELEKTIRKE)

- Kontrolli i pastërtise e përgjithshme të instalimit të instrumentit, duke u siguruar që zona të mos ketë mbeturina.
- Kontrolli i instalimit e cilindrit, kontrolloni sigurinë e të gjitha kllapave, kufizimeve .
- Kontrolli i të gjitha tubacionet e shkarkimit të jenë në gjendje të mirë pa dëmtime korrozioni dhe të jenë të sigurta
- Kontrolli dhe regjistrimi i leximeve te presionit nga të gjithë matësit e presionit të cilindrave Argon/N2. Presioni i cilindrit duhet të jetë afërsisht 200 bar në 15°C. Për temperatura të tjera se 15°C, kontrolloni me grafikun që lidhet me ndryshimin e temperaturës për IG-01.
- Inspektoni tubacionin e shkarkimit duke kërkuar për dëmtime, sigurohuni që të gjitha mbështetësit e tubacioneve të jenë të fiksuara mirë për të parandaluar çdo lëvizje vertikale ose anësore gjatë shkarkimit.
- Sigurohuni që të gjitha grykat të mbeten të instaluar në vendet e duhura, sipas planeve të sistemit. - Kontrolloni të gjitha grykat për pengesa, duke u siguruar që asnjë objekt të mos jetë vendosur pranë grykave, gjë që do të parandalonte shkarkimin e duhur
- Kontrolli dhe regjistrimi i të gjithë matësive te presionit të cilindrave të azotit. Presioni i cilindrit duhet të jetë afërsisht 160 bar në 15°C. Për temperatura të tjera nga 15°C, kontrolloni me grafikun që lidhet me ndryshimin e temperaturës për IG-0. Zëvendësoni cilindrin e azotit nëse presioni është më i vogël 140 bar.

8.3 SISTEMI I FIKJES SE TURBINAVE ME CO2

- Kontrolloni kabllot, dhe mbështjelljet për dëmtime, siguri dhe gjendje të përgjithshme
- Verifikimi i sensorit te presionit
- Inspektimi i gjendjes se përgjithshme të valvulës solenoide, sigurohuni që nuk ka korrozion dhe se boja është në gjendje të mirë, shikoni për ndonjë dëmtim mekanik
- Prova e sensorit te peshes se bombulave CO2
- Izoloni sistemin e CO2 për të siguruar që sistemi të mos aktivizohet dhe nderprese operimin e turbniave.
- Lidhni një peshore susta me cilindrin CO2. Ngrini cilindrin me peshoren e lidhur.
- Kontrolloni peshen e cilindrave dhe verifikoni qe korrespondon me sasinë e lejuar të humbjes prej 5%).

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 14 of 21		

- Verifikoni që kundërpesha e pajisjes peshuese është e lirë për t'u lëvizur dhe bie në pozicionin poshtë.
- Verifikoni që celesi fundor funksionon në mënyrë korrekte.
- Shkëputni sustën dhe ktheni pajisjen e peshimit në brendësi
- Inspektoni gjendjen e përgjithshme të cilindrit të CO2 dhe sigurohuni që nuk ka korrozion dhe se boja është në gjendje të mirë, shikoni për ndonjë dëmtim mekanik
- Kontrolloni sistemin e fikjes në përputhje me instruksionet e prodhuesit.

8.4 TESTI FUNKSIONAL I HIDRANTEVE DHE RRJETIT TE HIDRANTEVE

Hidrantët e zjarrit do të testohen për të konfirmuar se vlerat e prurjeve të ujit plotësojnë kërkesat e projektimit.

- Për çdo hidrant në unazën kryesore, regjistroni vlerat
- Verifikoni prurjen dhe presionit të çdo hidranti, nëse përmbush parametrat e projektimit. Për prurje mund të përdoret depozite dhe kronometër në mënyrë që të matet prurja e çdo hidranti. -
- --Nëse për të matur presionin, mund të vendoset një manometër i kalibruar tek çdo hidrant dhe të lexohet vlera e presionit (Specifikimi: minimumi 7 barg).
- Gjithshtu duhet të kontrollohet distanca e hedhjes së ujit dhe të lexohet vlera e saj

Numrat e hidranteve që do të nënshtrohen testeve të mesiperme janë:

- N. 22 në ACS02
- N. 53 në ACS03

8.5 INSPEKTIMI I TUBAVE TE HIDRANTEVE

Kontrolli i tubave fleksibel të mbrojtjes nga zjarri konsiston në verifikimin sipas projektit të numrave të tubave dhe vendodhjeve të tyre. Gjithshtu çdo tub duhet të testohet me ujë dhe kontrollohet nëse ka dëmtime fizike si: perthyerje, çarje, deformime.

Numri i tubave është:

- N. 5 në ACS02
- N. 26 në ACS03

8.6 KONTROLLI I RREZERVUARIT TE UJIT

Për rezervuarin e ujit të zjarrit, Operatori Ekonomik duhet të kryejë:

- Verifikimin e pastërtisë së përgjithshme dhe instalimin e instrumentave
- Verifikimin e instalimit, kontrolli i sigurisë së të gjitha kllapave, mbrojtësve dhe kapësve.
- Verifikimin i të gjitha tubacionet e shkarkimit janë në gjendje të mirë pa dëmtime korrozioni dhe të sigurta.
- Verifikimi i treguesit të nivelit mekanik.
- Verifikimi i treguesit elektronik të nivelit.

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 15 of 21		

Verifikimi i funksionimit te instrumenteve të rezervuarit të ujit të zjarrit dhe simulimi i sinjaleve sipas instruksioneve te prodhuesit

8.7 KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES JOCKEY

Për rezervuarin e ujit të zjarrit, Operatori Ekonomik duhet te kryejë:

- Verifikimin e pompës, për pastërti të përgjithshme dhe shenja dëmtimi.
- Verifikimin e fllanxhave te lidhura të tubacioneve për ndonjë shenjë rrjedhjeje dhe gjendjen e bulonave të fllanxhave.
- Verifikimin e gjendjes se bulonave dhe pjeseve mekanike
- Verifikimi i vibrimeve apo zhurmave jo normale qe mund te ndikojne operimin
- Kryerja së bashku me personelin e AGSco një test funksioni dhe shikoni se pompa po funksionon sipas parametrave të projektimit.

8.8 KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES ELEKTRIKE

Për rezervuarin e ujit të zjarrit, Operatori Ekonomik duhet te kryejë:

- Verifikimin e pompës, për pastërti të përgjithshme dhe shenja dëmtimi.
- Verifikimin e fllanxhave te lidhura të tubacioneve për ndonjë shenjë rrjedhjeje dhe gjendjen e bulonave të fllanxhave.
- Verifikimin e gjendjes se bulonave dhe pjeseve mekanike
- Verifikimi i vibrimeve apo zhurmave jo normale qe mund te ndikojne operimin
- Kryerja së bashku me personelin e AGSco një test funksioni dhe shikoni se pompa po funksionon sipas parametrave të projektimit.

8.9 KONTROLLI DHE TESTI FUNKSIONAL I POMPES DIESEL

Për rezervuarin e ujit të zjarrit, Operatori Ekonomik duhet te kryejë:

- Verifikimin e pompës, për pastërti të përgjithshme dhe shenja dëmtimi.
- Verifikimin e fllanxhave te lidhura të tubacioneve për ndonjë shenjë rrjedhjeje dhe gjendjen e bulonave të fllanxhave.
- Verifikimin e gjendjes se bulonave dhe pjeseve mekanike
- Verifikimi i vibrimeve apo zhurmave jo normale qe mund te ndikojne operimin
- Kryerja së bashku me personelin e AGSco një test funksioni dhe shikoni se pompa po funksionon sipas parametrave të projektimit.

8.10 KONTROLLI I SISTEMIT TE SPRINKLERAVE DHE KONTROLLI I SISTEMIT TE SHKUMËS (TESTOHEN SEBASHKU)


Per te verifikuar kete sistem, operatori ekonomik duhet te kryeje minimalisht testet e meposhteme.

- Verifikimi qe sistemi eshte funksional ne perputhje me parametrat e projektimit

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 16 of 21		

- Prove funksionale e ketyre sistemeve dhe venja ne dukje e anomalive te mundshme
- Nuk jane kryer modifikime apo riparime te paautorizuara
- Sistemi eshte ne perputhje me projektin e mbrojtjes nga zjarri
- Verifikimi që kokat e sprinklerave janë të instaluara dhe të papenguara.
- Ne rast te proves funksionale, ooperatori ekonomik duhet te harantoje qe te vemndoset nje ene ne menyre qe te grumbulloj ujin ose shkumen
- Analiza e shkumes do te realizohet duke mare nje moster te shkumes ne impaint dhe dergesen e saj prane nje laborator te akredituar per testimin edhe verifikimin e mostres. Ne perfundim, operatori ekonomik do ti dorezoj autoritetit kontraktor fleten e analizes seshkumes.

Vendi i provës ndodhet poshte valvulës 710-HBV-0020



Duhet te hapet 710-HAV-0018 për të lëshuar vetëm ujin ne menyre qe te regjistrohet koha që duhet për të mbushur enen.

Kërkesa: 7,5 litra / min * m2 .

Pasi të përfundojë testi, duhet te mbyllet 710-HAV-0018

Kompania: 	Titulli i Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 17 of 21		

Ne kete menyre behet edhe verifikimi i funksionimit zanor të alarmit.

8.11 KONTROLI I DALJEVE EMERGJENCES DHE KONTROLI I SINJALISTIKES SE EMERGJENCES

Për daljet emergjente, Operatori ekonomik do të kryejë:

- Inspektimin e daljeve te emergjencës, sinjalistikes dhe dyerve.
- Inspektimi i planit të evakuimit dhe sigurohimi që tabelat dhe dera janë funksionale
- Verifikimi i planit te evakuimit dhe dokumentat e projektit dhe ballafaqim9 i tyre me situaten ne terren.

9. RAPORTI I KONTROLLIT – CERTIFIKATA PERIODIKE VJETORE

Ne perfundim te verifikimit/kontrollit ne impiant, Operatori Ekonomik duhet te pergatise raportet e inspektimit, te cilat duhet të shoqërohen me Certifikatë Periodike Inspektimi siç kërkohet nga Klienti TAP dhe Ligjiet Shqiptar në fuqi. Raportet edhe Certifikatat perjodike vjetore duhet te dorezohen te vulosura dhe firmosura prane autoritetit kontraktor.

Raporti i inspektimit duhet te permbaje, të paktën sa më poshtë:

- Numri i raportit;
- Lloji i Inspektimit;
- Emri, sasia dhe kualifikimi i teknikëve të përfshirë;
- Datat e inspektimit;
- Pajisjet e përdorura
- Fotografi gjate testimi te sistemeve
- Periudha e kalibrimit të pajisjes,
- Pajisjet Zonat kritike ose zonat shqetësuese
- Rezultatet e testimeve
- Nëse pajisjet nuk janë të përshtatshme për punë, duhet të vihen në dukje mangësitë dhe rezultatet.
- Periudha e vlefshmërisë së inspektimit
- Nënshkrimi dhe vula e ekspertit zjarrfikës ose shoqërisë.
- Certifikata e konformitetit e njohur nga autoritetet shqiptare.

Raporti i inspektimit dhe Certifikatat duhet të dorëzohet në kopje të shtypura në më pak se 3 ditë pune pas inspektimit në vend.

10. SHSM (SHËNDETI, SIGURIA & MJEDISI)

Kontraktuesi do të zbatojë të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar, duke iu referuar në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 18 of 21		

- Kuadrin rregullator të mbetjeve në Shqipëri;
- Dispozitat lidhur me trajtimin e Covid-19;

Gjithashtu, Kontraktuesi do të jetë në përputhje me:

- AGSco-STD-001 "AGSco SHSM Standardet minimale për Kontraktuesit" (dhe ndryshimet vijuese), që janë të zbatueshme për aktivitetet e saj dhe që ofrohen së bashku me këtë objekt të shërbimeve.
- Politikat e klientit të AGSco-s, kur aktiviteti zhvillohet në vendndodhjet e Klientit.

Të gjitha procedurat përkatëse, që duhet të jenë të nevojshme, do të sigurohen pas dhënies së kontratës dhe në çdo rast përpara hyrjes në vendet operative.

Përveç të gjitha veprimeve të cilat kërkohen për zbatimin e legjislacionit shqiptar, Kontraktuesi duhet të përgatisë përpara fillimit të aktiviteteve, një Plan specifik të SHSM-së, që duhet të koordinohet me planin e AGSco-s, i cili përmban masat në funksion për trajtimin e rreziqeve të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit lidhur me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveçse sa përcaktohet në AGSco-STD-001, Plani i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit:

- do të përcaktojë veprimet që do të ndërmerren për të kontrolluar ato rreziqe në një nivel të pranueshëm;
- do të përfshijë një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent të angazhuar në kryerjen e punës;
- do të përshkruajë zbatimin e dispozitave të AGSco-s dhe klientit të AGSco-s në të gjithë zinxhirin e nën-kontraktimit, nëse do të jetë në funksion ndonjë nënkontratë;
- do të përcaktojë organizimin dhe përgjegjësitë mbi Cilësinë, Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin;
- do të përcaktojë mënyrën e menaxhimit të aspekteve mjedisore.

Kontraktuesit mund t'i kërkohet të monitorojë treguesit kryesorë të performancës në bazë mujore, sipas një modeli dhe shpeshësie që do të bihet dakord.

11.1 RREGULLAT E SJELLJES BRENDA AMBIENTEVE TË AGSCO-S OSE KLIENTIT TË AGSCO-S

I gjithë personeli i Kontraktuesit do të zbatojë rregullat e sjelljes, që janë vendosur në ambientet e AGSco-s dhe klientit të AGSco-s, përmes planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialit informues.

Nëse konstatohet se ndonjë nga personeli i Ofruesit të Shërbimit nuk zbaton rregullat e përmendura më lart, AGSco rezervon të drejtën të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimit që të zëvendësojë punonjësin menjëherë.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 19 of 21		

Në veçanti, i gjithë personeli do të përdorë PMP-të që identifikohen në dokumentin e vlerësimit të rrezikut të Kontraktuesit dhe Planin SHSM në Kontratë, sipas AGSco-STD-001 'AGSco SHSM Standardet minimale për kontraktuesit'.

11.2 TRAJNIMET

Në lidhje me trajnimet, dispozitat e përgjithshme të përcaktuara nga AGSco-STD-001 konsiderohen të vlefshme dhe Kontraktuesi është përgjegjës për të siguruar se personeli i tij është kompetent në lidhje me përmbajtjet e vlerësimit të tij të rrezikut dhe Planit SHSM të Kontratës.

Në veçanti, Kontraktuesi do të provojë, përmes certifikatave të trajnimit, regjistrave të trajnimit dhe vetë-deklarimeve, se personeli që do të përdoret për të ofruar shërbimet është kompetent, madje edhe në lidhje me ndonjë autorizim specifik të kërkuar nga ligji shqiptar.

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin të kërkojë në çdo kohë prova të aftësisë së personelit. Nëse konstatohet se dikush i përfshirë në ofrimin e shërbimeve nuk është kompetent për detyrën ose nuk është trajnuar në lidhje me kërkesat specifike të ligjit, AGSco mund t'i kërkojë Kontraktuesit të zëvendësojë detyrimisht personin me një person tjetër kompetent.

11.3 MBETJET QË KRIJOHEN NGA AKTIVITETET E KONTRAKTUESEVE DHE NËNKONTRAKTUESVE

Kontraktuesi është përgjegjës i vetëm për të gjitha mbetjet që krijohen nga aktivitetet e tij (urbane, speciale, të rrezikshme dhe të parrezikshme) në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Në veçanti, Kontraktuesi i Shërbimit do të sigurojë përmbushjen në mënyrë të saktë të sa më poshtë vijon:

- Menaxhimin;
- Karakterizimin dhe klasifikimin, aty ku kërkohet;
- Transportin dhe dërgimin në një mjedis të përshtatshëm të mbetjeve;

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin, për të kontrolluar nëse mbetjet e prodhuara nga Kontraktuesi menaxhohen në përputhje me legjislacionin aktual, duke kërkuar dokumentacionin model ose kryerjen e kontrolleve.

11. DETYRIMI I KONTRATËS

12.1. DETYRIMET E KONTRAKTORIT

Operatori ekonomik :

o Eshte përgjegjës për të caktuar ekipin kompetent dhe të kualifikuar të HSEQ.

o Eshte përgjegjës për të caktuar Personin Përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë .

o Duhet te disponoje personel kompetent, të kualifikuar, të kualifikuar dhe me përvojë për të kryer Shërbimet.

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
	Faqe 20 of 21		

o Eshte pergjegjes per sigurimin e personelit të tyre të mirëmbajtjes, veshje mbrojtëse dhe pajisje sigurie në përputhje me standardin HSE të Kompanisë.

o Kryen të gjitha aktivitetet paraprake dhe aktivitetet përfundimtare sipas kërkesave të AK (dokumentacioni HSE dhe PTW, përgatitja e propozimit, raportimi, kontabiliteti, etj.

o Siguron mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e Shërbimeve.

o Të jetë përgjegjës për mobilizimin dhe demobilizimin e personelit, pajisjet, mjetet dhe materialet për të kryer Shërbimin. Kostot MOB/DEMOB për personelin dhe pajisjet përfshihen në tarifat për njësi për personelin dhe pajisjet. Kostot e transportit të materialeve (jo materialeve harxhuese) do të konsiderohen brenda tarifave për njësi për marrjen me qira të pajisjeve dhe personelit për transportimin e këtyre materialeve në vendin e dorëzimit.

o Eshte përgjegjës për të gjitha shpenzimet e transportit, akomodimit.

o Eshte përgjegjës për ngarkimin, transportin, shkarkimin dhe trajtimin e çdo teprice materiale në Depot e Klientëve të Kompanisë dhe Kompanisë.

o Të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve në terren.

o Informon Kompaninë sa më shpejt që të jetë e mundur për çdo fakt, ngjarje ose situatë që mund të shkaktojë paragjykim ndaj Kompanisë, duke përfshirë, pa kufizim, çdo ngjarje për të parandaluar, shmangur ose zbutur çdo dëmtim të individëve, dëmtim ose humbje të pronës.

o Sigurohet që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me HSE të Kompanisë dhe procedurat e Klientit të Kompanisë.

10.2. DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTOR

- Eshte përgjegjës për të caktuar pikat/pikat teknike të kontaktit që do të jenë përgjegjëse për koordinimin e Shërbimeve.
- Rezervon të drejtën për të modifikuar ose anuluar çdo shërbim.
- Rezervon të drejtën për të inspektuar të gjitha aktivitetet.
- Rezervon të drejtën për të pranuar ose refuzuar çdo aktivitet të bazuar në cilësi, duke kërkuar ripunim nëse gjykohet e nevojshme.
- Duke ruajtur të drejtën për të ndërprerë çdo punë në terren, AK do të informojë menjëherë OE për arsyet dhe kohëzgjatjen e pritshme të ndalimit të ecurisë së punës.
- Sigurimi i aksesit të kontraktorit në objekte.

10.3. TË DORËZUESHME TË KONTRAKTORIT

OE është përgjegjës për të ofruar të gjitha dërgesat e kërkuara për të përfunduar Shërbimet. Kontraktori do t'i dorëzojë kompanisë materialet e mëposhtme, si minimum:

o Para konfirmimit nga AK për shërbimin e kërkuar OE duhet:

- Propozim i përgatitur sipas çmimoreve të kontratës
- Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të konsideruara për të justifikuar propozimin e paraqitur, një listë kufizimesh, nëse ka, dhe koha për të filluar dhe përfunduar shërbimin

Kompania: 	Titulli I Dokumentit: MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË ZJARRIT DHE GAZIT Specifikimet Teknike	Nr. Ref. i Dokumentit: AGS-TSP-001	
	Albanian Gas Service Company Sh.A. Rruga "Kosovareve", pallati NderPro Sh.P. Tirana, Albania - NUIS: L82407006D	Rev. 0	25.01.2021
		Faqe 21 of 21	

- Data e fillimit të shërbimit ose orarit të ndërhyrjes sipas prioritetit të urdhrave të punës së mirëmbajtjes.
- Metodologjia dhe vlerësimi i rrezikut për aktivitetin që do të kryhet. Kjo do të jetë pjesë e propozimit komercial

o Pas konfirmimit nga AK për shërbimin e kërkuar OE duhet:

- Vendosi ne dispozicion listën e pajisjeve dhe personelit me kopje të të gjitha certifikatave (p.sh. trajnimet dhe certifikatat për personelin; certifikatat, raportet e inspektimit të pjesës së tretë, certifikatat e kalibrimit, librat e mirëmbajtjes, etj. për pajisjet)

OE duhet te Pergatise dhe nënshkruaj:

- Leja e punës sipas procedurës së klientit të kompanisë
 - Raporti i aktiviteteve të AGSco Start
 - Raportin e Perfundimit te aktiviteteve
 - Fleta kohore e nënshkruar për personelin dhe pajisjet, me çmime
 - Faturë e nënshkruar për materialet, me çmimet e kontrates
 - Raportin përfundimtar me dëshmi të aktiviteteve të kryera
- Ditën e parë të punës të çdo muaji, Kontraktori do t'i dërgojë një raport Kompanisë. Minimumi raporti duhet të detajojë:
 - Situata e përgjithshme e kontratës:
 - Numri ose porosinë e kryera të punës, shuma totale e përdorur e kontratës, vlera e disponueshme e kontratës
 - Për çdo "Faturë" në kontratë, situata në lidhje me sasinë e përdorura, sasinë e kryera, sasinë në dispozicion.
 - Situata e përgjithshme e KPI HSE

12. Garancite

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë këto sigurime:

- Sigurimi i pergjegjesise profesionale për të mbajtur operatorin të dëmshpërblyer për çdo humbje, dëmtim, kosto etj. në lidhje me çdo dëmtim të çdo personi dhe çdo dëmtim të pronës për një vlerë prej min 200.000 euro.
- Sigurimi në lidhje me anulimin e shërbimeve.